

Përmbledhje Jo-Teknike

SAMA CONSTRUCTION

11/29/2017

LOERMA SHPK

I. Të përgjithëshme.

i. Shoqëria "SAMA CONSTRUCTION" sh.p.k.

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar me emër subjekti "SAMA CONSTRUCTION" sh.p.k. është regjistruar me datë 16.07.2015 në Qendrën Kombëtare të Bisnesit (QKB) me numur unik identifikimi të subjektit (NIPT) L53116202S

Objekti i veprimtarisë së subjektit "SAMA CONSTRUCTION" sh.p.k. është: *"Prodhime saldimi, punime elektrike, gome, skrapit e tregeti i tyre, eksport import me pakice dhe shumice te artikujve industriale, ushqimore.*

Administratori i këtij subjekti është z. Juljan Prifti me afat emërimi nga: 15.07.2015 deri 15.07.2020

Zyrat qendrore të shoqërisë SAMA CONSTRUCTION shpk, janë në adresën Elbasan, Elbasan, ELBASAN, Lagja 28 Nëntori, Rruga 11 Nëntori, Zona Kadastrale nr.8523, pasuria me nr. 9/110, kati 2.

Kompleksi i ish Kombinatit Metalurgjik, këto 25 vitet e fundit po transformohet në një zonë të zhvilluar industriale, duke shfrytëzuar infrastrukturën inxhinjrike egzistuese si dhe duke kryer investime të rëndësishme në instalimin e teknologjive të reja prodhuese.

Subjekti "sama construction" sh.p.k. ka disa vite që ka përshtatur një nga ndërtesat e ish kombinatit të nikelit dhe kobaltit, dhe ushtron veprimtarinë në prodhime metalike (saldim-perçinim), punime elektrike, gome, përpunime skrapit metalik, etj.

Subjekti ka kryer investime në rikonstruksionin apo mirëmbajtjen e godinave, rrjeteve inxhinjrike, instalimin e makinerive e paisjeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë.

ii. Legjislacioni mbi të cilin mbështetemi.

- Ligji Nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" (i ndyshuar).
- Ligji Nr.10 448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit" (i ndyshuar).
- Ligji Nr. 10 440, datë 07.07. 2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" (i ndyshuar).
- Ligji Nr.10 463, datë 22.09.2011 Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve.
- Ligji Nr.10 266, datë 15.04.2010 " Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin NR.8897, datë 16.05.2002 "Për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja" (i ndyshuar).
- Ligji nr.9774, datë 12.07.2007 "Për Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në Mjedis".
- Ligji nr. 9115, datë 24.07.2003 "Për Trajtimin Mjedisor të Ujërave të Ndotur".
- V.K.M nr. 435, datë 12.02.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë".
- V.K.M Nr.177, datë 31.03.2005 " Për Normat e Lejuara të Shkarkimeve të Lengëta dhe Kriteret e Zonimit të Mjedisve Ujore Pritëse".
- V.K.M. Nr. 247, date 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore".

- V.K.M Nr. 1189, datë 18.11.2009 “Për Rregullat dhe Proçedurat për Hartimin dhe Zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit”.
- V.K.M Nr. 99, datë 18.02.2005 “ Për Miratimin e Katalogut Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve.

a) Qëllimi i projektit të propozuar.

Veprimtaria që ne vlerësojmë ka të bëjë kryesisht me përpunimin e lllamarinave e të profileve të ndryshme metalike kryesisht, prej çeliku duke prodhuar konstruksione të madhësive e konfiguracioneve të ndryshme të cilët përdoren si elementë ndërtues kryesisht të pajisjeve, linjave teknologjike, veprave apo godinave industriale.

Krahas përpunimit të materialeve prej çeliku, subjekti përpunon edhe materiale të metaleve të tjerë si alumine, etj. duke prodhuar kryesisht kazanë për depozitimin e mbetjeve urbane në qendrat urbane të vendit.

Subjekti tashmë ka arrirë parametrat e projektit në sasinë e lëndës parë që përpunon si dhe sasinë e cilësinë e produktit të prodhuar. Ai ka programe për të përmirësuar treguesit e humbjeve teknike si dhe kushtet e sigurisë në punë dhe impaktet në mjedis.

b) Planimetrinë e vendndodhjes së projektit, (ku pasqyrohen në hartëtopografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat, sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGE, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë).

Bashkangjitur keni planimetri të vendndodhjes së projektit.

Është një projekt i cili është ideuar dhe zbatuar në periudhën e viteve 1970 – 1975, si pjesë e projekteve ndërtimore të uzinës së përpunimit të mineralit të hekur-nikelit, apo si njëri në ato vite e Uzinës nr 12.

Objekti ku ushtron veprimtarinë Subjekti JUNDRIIT shpk, gjendet në krahun e majtë të rrugës automobilistike, që shkon në brendësi të teritorit që dikur thirrej uzina e nikel-kobaltit apo uzina 12. Ky objekt është i lidhur me infrastrukturën inxhinjerie të kësaj zone industrial si dhe me rrjetin rrugor dhe hekurudhor të saj dhe atë kombëtar.

Objekti përfshihet në koordinatat e pasqyruara në vijim (sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGE).

X1 = 45 50 818.094 X2 = 45 50 929.154 X3 = 45 50 901.521 X4 = 45 50 820.453

Y1 = 44 18 875.045 Y2 = 44 18 943.465 Y3 = 44 18 959.950 Y4 = 44 18 776.432



Trualli mbi të cilin janë ndërtuar objektet ku zhvillohet kjo veprimtari zë një sipërfaqe prej 9079 m² prej së cilës është e zënë me ndërtime një sipërfaqe prej 1504 m² ose rreth 16 % e saj, pra një koeficient mjaft i ulët i shfrytëzimit të tij. Ky trull kufizohet :

- Nga Veriu : objekt i përpunimit mekanik të metaleve dhe rrugë automobilistike e ishkombinatit që lidh këtë objekt me rrugën kombëtare.
- Nga Lindja : rrugë automobilistike e ishkombinatit dhe disa shtëpi banimi të ndërtuara pas viteve 1990 dhe që janë në proces legalizimi.
- Nga Jugu : kantjer i përpunimit të inerteve dhe disa shtëpi banimi të ndërtuara pas viteve 1990 dhe që janë në proces legalizimi.
- Nga Perëndimi : objekte të ish kombinatit metalurgjik,

Në Veri të këtij objekti, në një distacë ajrore prej rreth 100 - 150 m, disa prej objekteve të ish kombinatit janë shndërruar në ambjente banimi ku jetojnë rreth 20 - 30 familje të ardhura nga zona të ndryshme rurale. Po kështu, në Jug-Lindje të tij në një distacë ajrore prej rreth 100 - 150 m, gjenden disa shtëpi banimi të ndërtuara pas viteve 1990 të cilat janë të përfshira në procesin e legalizimit.

Duke vlerësuar impaktet negative në mjedis nga zhvillimi i kësaj veprimtarie, duhet të pohojmë se influencat në drejtim të këtyre “banesave” janë minimale.

Është në strategjinë e zhvillimit rajonal që të gjithë objektet e ish kombinatit të privatizohen për t’u shfrytëzuar në drejtime të ndryshme industriale e prodhuese, për faktin që e gjithë kjo zonë

ka një infrastrukturë të plotë të mirëmbajtur dhe deri diku funksionale e cila me pak shpenzime mund të adoptohet sipas proceseve të kërkuara.

- c) Informacionin për qendrat e banuara, në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti.

C.1. Vendndodhja e veprimtarisë.

Objekti ku zhvillohet veprimtaria që ne vlerësojmë, është pjesë përbërëse e ish Kombinatit Metalurgjik, dhe është nën juridiksionin e Njësisë Administrative Bradashesh, të Bashkisë Elbasan.

Sipërfaqja e përgjithëshme e sheshit të ndërtimit është 9079 m² prej së cilës është e zënë me ndërtime një sipërfaqe prej 1504 m² ose rreth 16 % e saj, pra një koeficient mjaft i ulët i shfrytëzimit të tij.

Trualli kufizohet nga të katër anët e horizontit, me objekte të ish kombinatit metalurgjik.

Teritori i Njësisë Administrative Bradashesh ndodhet në pjesën qendrore të Shqipërisë, në perëndim të qytetit të Elbasanit, në fushën me të njëjtin emër. Relievi është tipik fushor e kodrinor i thyer, por me maja të buta. Kodrat ndodhen në krahun e majtë të përroit të Kushës me: Kodrat e Kusarshit, Balzës (ku shtrihet fabrika e Çimentos), Gurabardhit, Karakullakut (veshur me dushk), Kozanës, maja e Fungut, maja e Cirrumullit.

Në të djathtë të përroit të Kushës deri tek përroi i Kaliçovës ngrihet grupi i kodrave të Bradasheshit-Fikas (të veshura me ullinj e fiq) e të Shijonit. Grupi i fundit i kodrave është ai që fillon nga Balldreni – Jateshi – Shëmhilli.

Njësia Administrative Bradashesh përfshin 17 fshatra. Bradashesh, Balëz Lart, Balëz Poshtë, Kusarth, Kozan, Karakullak, Letan, Rrilë, Shtëmaj, Ulën, Katund i ri, Fikas, Patresh, Shënmëhill, Shijon, Reçan, Gurabardhë, me rreth 12650 banorë. Ajo shtrihet në një sipërfaqe prej 55,2 km². Sipërfaqja e tokës bujqësore është 1600 ha dhe sipërfaqja e pyjeve dhe kullota është 2092 ha.

Drejtimi kryesor i ekonomisë është prodhimi i drithrave të bukës dhe rritja e lopëve dhe të imtave kryesisht dhenve. Krahas prodhimeve bujqësore sot aty veprojnë rreth 95 biznese, ndër të cilat uzina e prodhimeve të çeliqueve, dhe e prodhimit të gëlqeres të Kompanisë KURUM INTERNATIONAL, fabrika e prodhimit të çimentos, disa linja të prodhimit të gazit sulfuror (SO₂), të magazinimit dhe tregtimit të karburanteve dhe të GLN, të prodhimit të tubove plastike, prodhimeve të ndryshme metalike, drurit, etj.

Krahas këtyre linja industriale, janë zhvilluar edhe biznese të shërbimeve dhe tregtimeve ushqimore, hoteleri, bar-restorante, etj.

Në këtë njësi administrative gjenden disa monumente kulture si : **Stacioni Ad-Quintum** që është trakt i Rrugës Egnatia dhe që është shpall si monument kulture në vitin 1963, Kalaja në vendin e quajtur **Shkëmbi i Skenderbeut** , në fshatin Petresh e shpallur si monument kulture në

vitin 1973, **Manastiri i Shën Gjon Vladimirit** (që daton nga periudha e bizantin), **Çezmja e Kasinës** etj.

Stacioni rrugor Ad–Quintum ndodhet në gjendje të mirë për tu vizituar në fshatin Bradashesh. Ai është ndërtuar në shekullin II-të pas Krishtit përgjatë rrugës Egnatia për t'i shërbyer udhëtareve. Ai përbën një kompleks së bashku me ninfeun të vendosur në sipërfaqe katërkëndëshe 45 x 12 metra. Numri i vendeve për të shërbyer është i vogël por, ai përmban të gjitha kthinat kryesore, dhomat e zhveshjes, ambientin e ngrohtë, ambientin e nxehtë si dhe atë me ujë të ftohtë. Banjot e këtij stacioni kanë një zgjidhje racionale planimetrike dhe estetike.

Kisha e Shën Gjon Vladimirit ndodhet në fshatin Shijon, në afërsi të rrugës Egnatia, në një prej degëzimeve të saj, që të çon në drejtim të Petrelës. Gjon Vladimiri, princ i Krajës, u vra në Prespe me 4 Qershor 1016, në luftë kundër bullgareve. Ai u varros në Krajë nga e shoqja Kosara. Kisha e shpalli shenjtor dhe Perandori bizantin Mihal Komneni e zhvarosi dhe e solli skeletin (lipsanin) në Durrës. Karl Topia e solli në Shijon, ku kishte një kishë të vjetër, të cilën ai e rindërtoi dhe e zgjeroi me përmasat e një manastiri ortodoks në vitin 1381. Në derën e manastirit ishte stema e Karl Topisë me dedikimin të gdhendur në 3 gjuhë, latine, greqisht dhe sllavisht. Në vitet në vijim aty fillojë të zhvillohej çdo vit, pazari/panairi i gjësë së gjallë, me përmasa kombëtare, por edhe me pjesmarrje nga viset e Ballkanit.

C.2. Tregusit gjeologo-inxhinjrikë të zonës.

Gjeologjia. Vëndi ku zhvillohet kjo veprimtari është pjesë perëndimore e fushës së Elbasanit. Zona përfaqëson depozitimet aluviale të Fushës së Elbasanit të cilat janë me trashësi relativisht të madhe. Në këtë fushë kemi depozitime të përmbysura gjë që do të thotë se teraca më e vjetër është më në thellësi. Këto depozitime përbëhen nga aluvialo proluviale dhe kanë trashësi mbi 40 m në pjesën periferike të fushës dhe 85 m në qendër të saj.

Fusha e Elbasanit shtrihet nga Fshati Labinot Fushë dhe deri në grykën e Paprit. Ajo është një fushë e formuar në periudhën e Kuaternarit dhe nga pikpamja gjeologjike në të takojmë :

- depozitimet e Oligocenit të Mesëm;
- depozitimet e Oligocenit të Sipërm;
- depozitimet e Tortonianit;
- depozitimet e Kuaternarit.

Depozitimet e Oligocenit të Mesëm, takohen në të tre nënzonat tektonike duke marrë pjesë në ndërtimin e krahëve të strukturave antiklinale dhe sinklinare. Në rajonet e pjesës qendrore të zonës Jonike këto depozitime përfaqësohen nga flish argjilor kryesisht ritëm mesëm me shtresë gëlqerori mikritik, biomikritik e turbiditik. Karakteristikë dalluese është rritja e shtresave gëlqerore nga lindja në perëndim jo vetëm si numur por, edhe si trashësi dhe zvogëlimi i komponentit ranor deri në zhdukje.

Depozitimet e Oligocenit të Sipërm, kanë përhapje më të kufizuar në krahasim me ato të Oligocenit të Poshtëm dhe të Mesëm. Në përgjithësi në pjesën e sipërme të këtyre depozitimeve mbizotërojnë ranorë të cilët heraherës kalojnë në ranorë masivë. Këto depozitime janë reduktuar dhe përfaqsohen nga flish argjilor që i përket formacionit “SEFAJ”. Këto depozitime pësojnë ndryshime të theksuara nga lindja në perëndim dhe nga jugu në veri. Trashësia e depozitimet e Oligocenit të Sipërm luhetet nga 1140 m në lindje e deri në 390 m në perëndim.

Depozitimet e Tortonianit, përgjithësisht përfaqësohen nga ndërthurje midis pakove të trasha ranore me argjila alevrolitore. Ranorët janë me ngjyrë gri të zverdhur, kokërr mëdhenj, ku dallohet qartë granoklasimi vertikal. Zakonisht ranorët paraqiten në formë shtresash, trashësi e të cilave luhetet 1 deri 2 metra dhe ndahet nga shtresa të holla centimetrike alevrolitesh duke formuar kështu një pako të tërë me trashësi 4–5 m deri 10–12 m. Alevrolitet paraqiten me ngjyrë gri hiri, dhe përmbajnë shpesh herë linza qymyresh mjaft të holla 1–2 cm si dhe makrofaunë të ndryshme. Ato formojnë paketa me trashësi 1-3 m të cilat rrallë herë arrijnë edhe trashësinë 7-8 m.

Depozitimet e Kuaternarit, përfaqsohen nga depozitime aluviale dhe depozitime proluviale. Depozitimet aluviale, përfaqsohen nga teraca akumulative dhe erozionale – akumulative dhe përhapen në rrjedhën e mesme dhe të sipërme të Lumit Shkumbin. Në luginën e Shkumbinit këto depozitime ndërtojnë teracën e shtratit si dhe depozitimet e sotme të shtratit. Këto depozitime kanë qënë dhe janë objekt i shfrytëzimit të inerteve pasi ato përbëhen kryesisht nga zhavore, zhure dhe rëra. Trashësi e tyre shkon 15 – 25 m.

Hidrogeologjia e zonës, Ujrat.

Rajoni ku zhvillohet aktiviteti përbëhet nga kompleksi ujëmbajtës i kuaternarit të cilët formojnë pellgun ujëmbajtës të pjesës së mesme të luginës së Shkumbinit. Këto ujra gjenden në shtesën e zhavoreve të zonës, në teracën e parë të lumit. Nështresa ujëmbajtëse freatike (pa presion) pasqyra e lirë përfaqëson kufirin e sipërm të zonës së ngopjes. Këta ujra ushqehen drejpërsëdrejti nga sipërfaqja e tokës nëpërmjet inflitrimëve të rreshjeve atmosferike. Zona e ushqimit përputhet me zonën e përhapjes së ujrave nëntoksore. Lidhja e mirë hidraulike e këtyre ujrave me ujrat e lumit kushtëzon edhe regjimin e ndryshueshëm të sasisë së tyre si dhe mundësinë e rritjes së rezervave të tyre duke rritur kështu mundësinë e shfrytëzimit të tyre nëpërmjet puseve dhe pompimit.

Hidrografia. Në teritorin e komunës rrjedh përroi i Kushës me degët e tij, si dhe përroi i Kalicovës. Në të ka disa burime nëntokësore, si dhe ujëmbledhës.

Trulli mbi të cilin ngrihet ky objekt është pjesë përbërëse e ish Kombinatit Hidrometalurgjik të Nikelit dhe Kobaltit, apo siç njihet ndryshe Uzina 12. Ai është plotësisht pjesë përbërëse e një zone industriale e ndërtuar si e tillë rreth viteve 1970. Në këtë zonë industrial funksionojnë

edhe veprimatri të tjera ku vlen të përmendim këto aktivitete, të ambalazhimit të gazit të lëngëshëm të naftës në bombola të përdorimit komunal, një tjetër impjant i prodhimit dhe të ambalazhimit të gazit SO₂, nyja e grumbullimit dhe përpunimit pjesor të skrapeve të hekurit, një repart i përpunimit mekanik të metaleve, fabrikën e prodhimit të materialeve për ndërtim kryesisht kollë, etj. dhe, më në distancë prodhimin e çelikut nga KURUM International sh.p.k., etj.

C.3. Kushtet metereologjike (klima erërat).

Sipas klasifikimit klimaterik të vendit tonë, të bërë nga Instituti Hidro Metereologjik i Akademisë së Shkencave, zona në të cilën zhvillohet projekti, ndodhet në zonën klimatike mesdhetare fushore të vëndit, që karakterizohet nga dimra të butë e të lagësht dhe verëra të nxehta e të thata.

➤ Temperatura.

Temperatura **mesatare** e ajrit varion nga 6-7 °C në Janar deri në 23-24 °C në Korrik. Temperatura mesatare **maksimale** varion nga 11 °C në Janar deri në 31 °C në Korrik. Temperatura mesatare **minimale** varion nga 2,2 °C në Janar deri në 15,8 °C në Korrik. Temperatura mesatare **minimale** varion nga 2,2 °C në Janar deri në 15,8 °C në Korrik. Temperatura **minimale** absolute është rregjistruar në Janar të vitit 1968 me - 7,5 °C dhe ajo maksimale absolute është rregjistruar në Korrik 1988 me 42 °C .


➤ Reshjet.

Përsa i përket rreshjeve, pjesa më e madhe e tyre bie në periudhën e ftohtë të vitit dhe më pak në periudhën e ngrohtë për shkak të, aktivitetit ciklonik. Gjatë periudhës së ftohtë të vitit bie 65,8 % e shumës vjetore të reshjeve dhe gjatë periudhës së ngrohtë 34,2 %. Shuma vjetore e reshjeve është 1148 mm, ndërsa maksimumi 24 orë i reshjeve është 134,9 mm. Reshje në formë bore janë dukuri e rrallë për këtë rajon. Numuri i ditëve me dëborë është i ulët dhe ka një vlerë mesatare prej 1,2 ditë në vit.

➤ Era.

Për zonën që vlerësojmë mund të thuhet se ajo karakterizohet nga vlera të larta të qetësisë në rreth 52 % të vitit. Shpejtësia mesatare minimale e erës është 1,2 m/sek. gjatë verës dhe shpejtësia mesatare maksimale është 2,1 – 2,4 m/sek. në dimër. Janë mbizotëruese gjatë gjithë vitit erërat që fryjnë nga Veri – Lindja. Në dimër ato arrijnë vlerën maksimale me 4,7 m/sek. Në pranverë, mbizotëruese janë erërat me drejtim Jug – Perëndim në gati 12 % të gjithë vitit. Përcaktimi i erërave mbizotëruese, dhe intensiteti i tyre, ka një rol kryesor në largimin dhe shpërndarjen e ndotësve, veçanërisht në këtë rajon që vlerësohet i ndotur për shkak të aktivitetit të prodhimit të çelikut, ferro-kromit, prodhimeve karbonike, etj. Në përgjithësi,

erërat konsiderohen faktorë pozitivë, meqenëse ato largojnë me shpejtësi ndotësit, duke penguar akumulimin e tyre, gjithmonë në rastin kur drejtimi i tyre mbizotërues nuk është i atij lloji që të lëvizë ndotësit në drejtim të zonave më të afërta të banuara.



➤ Ajri.

Ndotësit kryesor të ajrit urban janë LNP dhe PM₁₀ si dhe gaze të tilla si dyoksid e monoksid karboni (CO₂ e CO), dioksid i sqfurit (SO₂), okside të azotit (NO_x) etj. Këto ndotës gjenerohen nga linjat teknologjike të prodhimit të çeliqueve, prodhimeve karbonike, ferro-kromit, depozitimit dhe tregtimit të GLN, linjave të prodhimit të dioksidit të sqfurit (SO₂), etj.

C.4. Pejasazhi dhe Topografia.

Pejaszhi dhe ndërtimi topografik i rajonit ku zhvillohet kjo veprimtari është ai i një zone krejtësisht industriale, në të cilën mbizotërojnë aktivitete të ndryshme prodhimi dhe fare pak banesa publike të krijuara nga përshtatja e objekteve të ndryshme të ishkombinatit apo të ndërtuara në kufinj të zonës industriale këto vitet e fundit.

Zona vlerësohet përgjithësisht e sistemuar në drejtim të sistemimit të rrugëve automobilistike, rrjeteve të ujësjellësit dhe atij të shkarkimit të ujrave të ndotur. Rrugët përgjithësisht janë të ndriçuara.

C.5.Trashëgimia arkitektonike dhe historike.

Ushtrimi i këtij aktivitetit nuk prekin zona të mbrojtura me ligj si :

- ✚ rezervate kombëtare natyrore ;
- ✚ zona me interes shkencor të veçantë ;
- ✚ parqet kombëtare;
- ✚ zonat me bukuri të rrallë natyrore;
- ✚ zonat ujore të mbrojtura;
- ✚ zonat e mbrojtura;
- ✚ ndërtimet me vlera;
- ✚ monumente të lashtësisë ;
- ✚ zonat me rendësi arkeologjike, turistike, etj.

- ç) Skicat dhe planimetritë e objekteve dhe strukturave të projektin, si dhe mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit.

Veprimtaria e Subjektit “JUNDRIT” sh.p.k. ushtrohet në një objekt i cili është ndërtuar që në vitin 1975 dhe ka qënë në funksion të linjës teknologjike të ish kombinatit metalurgjik të nikel-kobaltit. Objektit që ka përfunduar së ndërtuari shumë vite më parë me të gjithë elementët përbërës të një vepre industriale, nuk ju ka ndryshuar destinacioni I veprimtarisë së zhvilluar në të. Gjatë këtyre viteve investitori ka kryer punime të mirëmbajtjes së godinës dhe rrjeteve inxhinjerike përkatëse, etj.

- d) Përshkrimi i proçeseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese/përpunuese, sasi të lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit.

d.1. Përshkrimi i proçeseve ndërtimore.


Veprimtaria e Subjektit “JUNDRIT” sh.p.k. ushtrohet në një objekt i cili është ndërtuar që në vitin 1975 dhe ka qënë në funksion të linjës teknologjike të ish kombinatit metalurgjik të nikel-kobaltit. Objektit që ka përfunduar së ndërtuari shumë vite më parë me të gjithë elementët përbërës të një vepre industriale, nuk ju ka ndryshuar destinacioni I veprimtarisë së zhvilluar në

të. Gjatë këtyre viteve investitori ka kryer punime të mirëmbajtjes së godinës dhe rrjeteve inxhinjrike përkatëse, etj.

Po gjatë kësaj periudhe janë kryer punime ndërtimi për përshtatjen apo ndërtimin e bazamenteve të reja në të cilat janë instaluar pajisje apo makineri të reja në përshtaje me zhvillimin e proçeseve teknologjike të reja.

d.2. Përshkrimi i proçeseve teknologjike.

Përpunimi i llamarinave dhe profileve të ndryshme metalike, kryesisht **ele, u, ti**, etj, prej çeliku, alumini, etj konsiston në kryerjen e operacioneve të tilla si :



- Prerjen e tyre në forma gjeometrike të madhësive të përcaktuara,
- Dhënien e formave të ndryshme gjeometrike, nëpërmjet proçeseve të tilla si kalandrimi (rrumbullakosja, përkulja në kënde të ndryshme, etj), përkulja, palosja, etj.
- Ngjitja e plotë ose e pjesëshme nën veprimin e harkut elektrik apo nga flaka e oksigjenit,

Këto proçese kryesore si dhe të tjerë proçese ndihmëse bëhen për prodhimeve individuale apo grupe detalesh në vartësi të porosive/kontratave të bëra me subjekte të ndryshme.

Personeli teknik bën përgatitjen e skicave teknike, porosinë e materialeve të nevojshme si dhe harton kartën teknologjike me operacionet përkatëse të punëve që duhen kryer për çdo detal dhe grup detalesh deri në përfundimin e plotë të porosisë që mund të jetë një detal i vetëm, një paisje, apo dhe një konstruksion i plotë metalik.

Kemi të bëjmë me punë kryesisht të veçantë gjë që nënkupton se nuk kemi prodhime në linjë dhe kështuqë, pajisjet e makineritë e instaluar punojnë në mënyrë individuale. Edhe punëtorët që shfrytëzojnë këto paisje kryejnë pothuajse punë individuale.

Ka raste që pajisje të veçanta apo grup pajisjesh shpesh nuk vihen në punë për periudha të gjata kohore. Kjo është e kondicionuar nga kontratat që realizohen me klientë të ndryshëm.

Për realizimin e punimeve të përshkruara më sipër dhe të tjera të ngjashme me to, në të dy repartet prodhuse të këtij subjekti janë instaluar makineri dhe paisje të specializuara, një pjesë e madhe e të cilave janë prodhime të viteve 1970-1980 të trashëguara nga ish reparti i saldimit perçinimit të ish kombinatit metalurgjik.

Ndër paisjet dhe makineritë kryesore të instaluar dhe që vijojnë të prodhojnë listojmë :

1. Trapan vertikal me elektromotorr 3.5 kw ;
2. Trapan bangoje dy copë, me elektromotorr 1.1 kw në të cilët mund të vendosen punto me diametër maksimal 13 mm ;
3. Trapan radial me tre elektromotorrë 4.0 kw, 1.5 kw dhe 0.5 kw ;
4. Dy torno hoorizontale ;
5. Kalandër e madhe me elektromotorr 22.0 kw në të cilën kalandrohen llamarina me trashësi deri 20 mm dhe, ku llamarina mund të bëhet rreth me diametër 300 mm;

6. Kalandër e vogël me elektromotorr 5.5 kw në të cilën kalandrohen lllarina me trashësi deri 20 mm dhe, ku lllarina mund të bëhet rreth me diametër 200 mm;



Pamje të reparte prodhuese



Pjegatrice



Presë



*Kalandër e mesme
dhe një tranxhë hidraulike.*



Aparat saldimi me tel

7. Kalandër e kthimit të buzëve me elektromotorr 2.5 kw ;
8. Kalandër e kthimit të tubave të vogla me elektromotorr 3.5 kw ;
9. Trashë për kthim tubash me dy elektromotorrë 7.5 kw dhe 1.5 kw ;
10. Tranxhë me freksion me elektromotorr 5.5 kw e cila mund të presë llamarina me trashësi deri 5 mm ;
11. Tranxhë e kombinuar hidraulike me elektromotorr 2.2 kw dhe fuqi maksimale deri 500 ton. Në të mund të priten llamarina me trashësi deri 20 mm ;
12. Pjegatrice hidraulike me fuqi maksimale deri 630 ton, me dy copë elektromotorr nga 11.0 kw, dy copë 2.5 kw, dy copë 1.5 kw dhe, një 4.0 kw ;
13. Pjegatrice mekanike ku mund të përpunohen llamarina me trashësi deri 2 mm dhe gjatësi 2000 mm;
14. Presë me dy copë elektromotor 2.2 kw, një 5.5 kw dhe, një 2.5kw;
15. Trashë për kthim tubash me dy elektromotorrë 7.5 kw dhe 1.5 kw ;
16. Tranxhë me freksion me elektromotorr 5.5 kw e cila mund të presë llamarina me trashësi deri 5 mm ;
17. Tranxhë e kombinuar hidraulike me elektromotorr 2.2 kw dhe fuqi maksimale deri 500 ton. Në të mund të priten llamarina me trashësi deri 20 mm ;
18. Pjegatrice hidraulike me fuqi maksimale deri 630 ton, me dy copë elektromotorr nga 11.0 kw, dy copë 2.5 kw, dy copë 1.5 kw dhe, një 4.0 kw ;
19. Pjegatrice mekanike ku mund të përpunohen llamarina me trashësi deri 2 mm dhe gjatësi 2000 mm;
20. Presë me dy copë elektromotor 2.2 kw, një 5.5 kw dhe, një 2.5kw;
21. Presë e krahëve me elektromotorr 11.0 kw ;
22. Presë hidraulike e këmishave me elektromotorr 4.5 kw ;
23. Tre sharra mekanike ;
24. Kompresor ajri (elektromotorr 11.0 kw N = 2930 rrot/min) ;
25. Vinxh urë me kapacitet 10 ton ;
26. Vinxh cjaç me kapacitet 5 ton ;
27. Auto Vinxh me kapacitet 3 ton ;
28. Dy gurë zmerile.

Krahas këtyre pajisjeve dhe makinerive kryesore përdoren edhe aparate saldimit me hark elektrik (gjeneratorë dhe transformatorë), aparate të saldimit me tel si dhe aparate të punimit me argon, acitilen, oksigjen, etj që shërbejnë për prerje ose ngjitje të metaleve të ndryshme. Subjekti zotëron sete të shumta të vegla të dorës në të cilët mund të përmendin, trapanët, gurët zmeril, kaçavida, pinca, çekanë, mjete ngritëse e transportuese etj.

Repartet teknologjike në të cilat janë instaluar makineritë dhe pajisjet e përshkruara më lart, kanë hapsirat e nevojshme për zhvillimin e punës normale si dhe për qarkullimin pa problem të punonjësve, lëndëve e materialeve që përpunohen si dhe për lëvizjen e produkteve.

Këto reparte prodhuese kanë një ndriçim natyral të përshtatshëm dhe ndiçimi i detyrueshëm kryhet në vende të posaçme pune. Hapsirat relativisht të mëdha si dhe aspiratorët e vendosur kryesisht në muret anësorë të tyre krijojnë një qarkullim të vijueshëm të ajrit duke siguruar një mikroklimë të përshtatshme për ambientet e punës.

Pavarësisht kapaciteteve individuale të makinerive e pasijeve, nivelet e prodhimit përcaktohen nga tregu i brendëshëm. Nga përvoja disa vjeçare niveli i prodhimit është rreth 200–300 ton pajisje apo konstruksione në vit.

Nisur po nga eksperiencia e punës, subjekti deklaron se ka rreth 10 % të sasisë së produktit mbetje teknologjike apo skarcitet. Mbetjet teknologjike janë pjesë apo copa që mbeten pa u futur në prodhim e që dalin gjatë prerjeve të llamarinave apo profileve të ndryshme. E gjithë kjo sasi materiali seleksionohet me synim rifutjen në përdorim në periudha në vijim dhe pjesa e mbetur shkon për skrap.

- dh) Informacioni për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja.

Aktiviteti zhvillohet në një zonë industrial me infrastrukture të plotë, me rrugë të asfaltuara, me rrjet inxhinjerik të plotë si në drejtim të furnizimeve energjitike ashtu dhe në drejtim të rrjetit të kanalizimeve për shkarkime të ndryshme.

- Rrjeti inxhinjerik i furnizimin dhe shpërndarjes së rrymës elektrike;

Subjekti furnizohet me energji elektrike nga nënstacioni elektrik i ish uzinës 12. Rryma elektrike merret nga rrjeti nëntoksor me kabëll të përshtatshëm për rrymë dy dhe tre fazore. Brenda reparteve prodhuese janë ndërtuar rrjetet e brendëshme përkatëse për shpërndarjes e rrymës tre fazore në të gjitha makineritë dhe pajisjet e instaluar aty. Po kështu është edhe rrjeti i brendëshëm i rrymës dy fazore e cila përdoret kryesisht për sistemet e ndriçimit të ambienteve të punës, zyrave e pajisjeve të tyre etj. Të dy këto rrjete kanë pajisjet e duhura teknike të vënies në punë dhe të ndalimit të makinerive, pajisjet e mbrojtjes nga mbingarkesat e rrymës dhe të tensionit, lidhjeve tokëzuese etj. Subjekti ka të instaluar pajisje elektrike me fuqi që shkon në nivelet e 670 kWh.

➤ Rrjeti inxhinjerik i furnizimit dhe shpërndarjes së ujit industrial dhe ujit të pijshëm; Subjekti JUNDRIIT shpk furnizohet me ujë të pijshëm dhe ujë industrial, nga rrjetet përkatëse të ish kombinatit metalurgjik.

Brenda objektit ka një rrjet të brendëshëm të shpërndarjes së ujit të pijshëm dhe atij industrial në të gjitha pikat konsumatore të tij.

Uji industrial nuk është pjesmarrës në asnjë prej proceseve teknologjike që zhvillohen në këtë veprimtari. Ai përdoret kryesisht për përdorim në ambientet hidro-sanitare si dhe për pastrimin/larjen e ambienteve të punës.

➤ Rrjeti i shkarkimit të ujrave të ndotura dhe ai i shkarkimit të ujrave të zeza.

Në zonën industrial të ish kombinatit metalurgjik kanë qënë ndërtuar dhe janë funksionale dy rrjete kanalizimesh për mbledhjen dhe shkarkimin e ujrave të ndotur dhe ujrave të zeza. Edhe në këtë objekt janë funksionale të dy këto rrjete, të cilët mbledhin dhe shkarkojnë ujrave e ndotur që dalin gjatë pastrimit të ambienteve të punës dhe ujrave e shirave dhe rrjeti i shkarkimit të ujrave të zeza. Të dy këto rrjete i shkarkojnë ujrave e tyre respektivë, në lumen Shkumbin.

➤ Rrjeti i rrugëve automobilistike të brendëshme dhe lidhja e tyre me rrugën kombëtare ;

Territori në të cilin ushtron aktivitet ky subjekt përshkohet nga disa rrugë të brendëshme automobilistike të cilat janë të lidhura me rrugën kryesore të kësaj zone industrial dhe, nëpërmjet saj me rrjetin rrugor kombëtar.

Njëkohësisht ky subjekt është i lidhur me rrjetin hekurudhor kombëtar, nëpërmjet rrjetit të brendëshëm hekurudhor të zonës industrial.

- e) Programi për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionimit të projektit.

e.1. Programi për ndërtimin.

Subjekti JUNDRIIT shpke ushtron veprimtarinë e tij në një objekt të ndërtuar dhe vënë në shfrytëzim në vitet 1975, si pjesë e objekteve të uzinës së prodhimit të nikel-kobaltit. Në vitin 1994, ky objekt është privatizuar nga subjekti JUNDRIIT shpk, duke vijuar të shfrytëzohet për të njëjtën veprimtari që ai është projektuar dhe ndërtuar. Nga periudha e privatizimit e deri më sot, në këto objekte janë kryer punime ndërtimi për mirëmbajtjen, ndërtime të bazamentave të reja për instalimin e makinerive të instaluar me qëllim përmirësimin e teknologjisë.

Këto të dhëna dëshmojnë se nuk kemi të bëjmë me plane apo programe për ndërtime të reja.

e.2. Kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit.

Subjekti JUNDRIIT shpk, ka mbi 20 vite që zhvillon suksesshëm veprimtarinë e tij, në prodhimin e konstruksioneve apo pajisjeve metalike. Sigurisht që gjatë kësaj periudhë relativisht të gjatë kohore, bisnezi ka patur ulë-ngritjet e tij financiare, por ai ka bërë investime të rëndësishme për përmirësimin e proceseve teknologjike.

Drejtnesit teknik dhe ligjor të subjektit, kanë programe ambicioze të zhvillimeve të reja teknologjike, me synim plotësimin e kushteve teknike të tregut të brendëshëm dhe pse jo dhe të tregut të huaj. Nuk disponohen programe për mbylljen e këtij aktiviteti dhe kështu nuk mund të pasqyrohen në këtë document.

Objekti është pjesë e një zone të kategorizuar prej shumë vitesh si zonë industrial. Ky kategorizim është i rëndësishëm për të kuptuar dhe vlerësuar se nuk mund të hartohen projekte për rehabilitim dhe kthim të teritorit në gjendjen e tij fillestare. Gjendja fillestare duhet të përcaktohet me vendime të posaçme të organeve përgjegjëse të qeverisjes qëndrore dhe vendore. Është një zonë e gjërë industrial që ka tjetërsu teritorin që nga viti 1970 e në vijim.

Proceset teknologjike që zhvillohen në këtë subjekt nuk mund ti klasifikosh si procese me risk ndaj mjedisit ku ato zhvillohen. Mund të pohojmë se janë mundësi tepër të vogla të rrishtit për zhvillim të aksidenteve me pasoja të rënda në mjedis. Mbështetur në këto vlerësime, nuk shihet e arsyeshme hartimi i programeve rehabilitues të teritorit të zotëruar nga ky subjekt.

- ë) Lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji).

Subjekti JUNDRIIT shpke ushtron veprimtarinë e tij në një objekt të ndërtuar dhe vënë në shfrytëzim në vitet 1975, si pjesë e objekteve të uzinës së prodhimit të nikel-kobaltit. Nga periudha e privatizimit e deri më sot, në këto objekte janë kryer punime ndërtimi për mirëmbajtjen, ndërtime të bazamentave të reja për instalimin e makinerive të instaluar me qëllim përmirësimin e teknologjisë.

Këto të dhëna dëshmojnë se nuk kemi të bëjmë me plane apo programe për ndërtime të reja. Kështu nuk mund të përshkruhen lëndët e para që janë përdorur për ndërtim para më shumë se 40 vitesh. Mungesa e programeve të reja për ndërtime nuk të japin gjithashtu mundësinë e përshkrimit të lëndëve të para që do të përdoren për ndërtim.

- f) Informacioni për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit.

Duke vlerësuar në tërësi të gjithë faktorët që influencojnë në zhvillimin e veprimtarisë së Subjektit JUNDRIIT shpk, duhet të pohojmë se egzistojnë lidhje edhe me projekte të tjerë që zhvillohen në afërsi të tij apo në të gjithë zonën industrial të ish kombinatit metalurgjik.

Lidhjet dhe ndërvartësitë janë në shfrytëzimin e rrjeteve inxhinjrike, rrjetit rrugor, influencës negative nga shkarkimet në mjedis të gazeve, pluhurave, zhurmave, ujrave të ndotur etj.

Subjektet e prodhimit të çeliqueve, gëlqeres, prodhimit të materialeve për ndërtim, etj. janë veprimtari me influence të ndjeshme jo vetëm në shfrytëzimin e rrjeteve inxhinjrike dhe rrjetit rrugor e hekurudhor por, edhe në gjenerimin e ndotësve të mjedisit.

g) Informacioni për alternativat e marra në konsideratë, për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret.

Subjekti JUNDRIIT shpk ka nisur veprimtarinë e tij prodhuese në dhjetor të vitit 1994. Është një periudhë relativisht e gjatë kohe, gjatë së cilës drejtuesit e tij kanë rivlerësuar zgjedhjet e tyre jo vetëm në vendit apo teritorit ku zhvillohet kjo veprimtari por edhe të teknologjive që zbatohen aty.

Në vijim pasqyrohen arsyet për zgjedhjen e alternativave më të mirë për zgjedhjen e vendit dhe teknologjive të zbatuara.

g.1. Arsyet për zgjedhjen e vendit :

- Përfshihet brenda një zone industrial.
- Object industrial I ndërtuar në përshtatje me veprimtarinë që zhvillohet.
- Infrastrukturë inxhinjrike e plotësuar për furnizimin me energji elektrike, ujë të pijshëm dhe ujë industrial, rrjet kanalizimesh për mbledhjen dhe shkarkimin e ujrave të ndotr dhe ujrave të zeza etj.
- Rrjet rrugor automobilistik dhe hekurudhor funksional për lidhje me rrjetet përkatëse kombëtare.
- Teritor larg qendrave të banuara, qendra sociale, zona të mbrojtura etj.

g.2. Arsyet për zgjedhjen e teknologjive:

- Egzistenca e mjaft makinerive teknologjike për zhvillimet e proceseve teknologjike të programuar.
- Egzistenca e punonjësve me eksperiencë pune në zhvillimin e këtyre proceseve teknologjike
- Munësi e prodhimeve të larmishme në sasi të vogla, gjë që jep mundësi të plotësimit të kërkesave të klientëve të ndryshëm.
- Kërkesat e tregut vendas për prodhime të realizuar nga kjo veprimtari.
- Hapsira të mjaftueshme për rinovim të teknologjisë, vendosjes së makinerive të reja etj.

gj) Të dhënat për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasinë e ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre.

gj.1. lëndët e para.

Në lëndë të para të përdorura në realizimit e prodhimeve të kësaj veprimtarije duhet të përmendim:

- Lllamarinat prej çeliku të markave të ndryshme si dhe të dimensione të ndryshme kryesisht në trashësinë e tyre.
- Profile prej çeliku të markave të ndryshme si rrethor, ele, dopio ti, etj. të dimensioneve të ndryshme.
- Lllarina prej çeliku të pandryshkëm, të dimensione të ndryshme kryesisht në trashësinë e tyre.
- Lllarina prej alumini të dimensioneve të ndryshme.
- Profile prej alumini të llojeve dhe dimensioneve të ndryshme.
- Elektroda për saldimit me hark elektrik, të cilat përdoren për saldimet e çelikeve, gizave, inokseve, aluminit etj.

Të gjitha emërtimet e lëndëve të para sigurohen në tregun e vendit apo në tregun e huaj. Të gjitha emërtimet nuk janë prodhime të vendit dhe ato blihen në subjekte të licensuar për importin dhe tregtimin e tyre. Sasia vjetore e tyre është 270 -330 ton.

gj.2. sasinë e ujit të nevojshëm.

Subjekti JUNDRIIT shpk furnizohet me ujë industrial dhe ujë të pijshëm. Uji industrial nuk është pjesmarrës në zhvillimin e proceseve teknologjike që zhvillohen në këtë veprimtari. Ai përdoret kryesisht për larjen e ambjenteve të punës si dhe për përdorim në ambjentet hidro-sanitare.

Sasia mesatare e përdorimit të ujit është rreth 20 m³/muaj.

gj.3. sasinë e energjisë.

Subjekti JUNDRIIT shpk për zhvillimin e veprimtarisë së tij përdor energji elektrike e cila merret nga nënstacioni elektrik I zonës industrial.

Subjekti ka një konsum relativisht të madh të energjisë elektrike, për arsye të fuqisë elektrike relativisht të lartë të instaluar këtu, rreth 670 kWh.

gj.4. sasinë e lëndëve djegëse.

Për plotësimin e kërkesave të zhvillimit normal të kësaj veprimtarije, subjekti konsumon disa lloje lëndësh djegëse si :

- Naftë dhe benzinë.

Nafta dhe benzina përdoren nga mjetet e transportit që zotëron subjekti. Këto mjete transporti përdoren për transportin e lëndëve të para dhe të atyre ndihmëse, për transportin e prodhimeve të realizuar si dhe për transportin e punonjësve.

Subjekti zotëron dhe shfrytëzon edhe disa mjete ngritëse e transportuese të cilat përdoren për transportet e materialeve të ndryshme, me pasha relativisht të mëdha brenda objektit. Sasitë e konsumit të naftës dhe benzinës shkojnë në nivelet e 500 – 600 litra/muaj.

- Gaz i lëngëzuar i naftës (butoa +propan).

GLN përdoret kryesisht në proceset e prerjeve dhe ngjitjeve nën flakën e kanellave të oksigjenit. Është një përdorim i kushtëzuar i GLN për plotësimin e kërkesave të proceseve të tilla teknologjike.

GLN përdoret për ngrohje gjatë stinës së ftohtë të vitit. Në hapsirat punuese të objektit, janë vendosur disa soba ngrohëse të cilat përdorin GLN.

Ai vjen në subjekt i ambalazhuar në bombolat përkatëse. Konsumimi i GLN është relativisht më i madh gjatë stinës së ftohtë të vitit. Mesatarish konsumi i tij shkon në 250 litra/muaj.

- Oksigjeni i lëngëzuar.

Oksigjeni i lëngëzuar përdoret gjatë zhvillimit të proceseve të prerjes apo ngjitjes nën flakën e kanellës së oksigjenit. Ai vjen në subjekt i ambalazhuar në bombolat përkatëse. Konsumi mesatar i oksigjenit është rreth 200 litra/muaj.

- h) Aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.

Nuk është e nevojshme zbatimi i projekteve të tjera si ndërtim i kampeve apo rezidencave. Në subjekt ponojnë rreth 20 punonjës, pjesërisht banorë të zonës së banuar që gjendet pranë kësaj veprimtarije dhe pjesa tjetër banorë të qytetit të Elbasanit. Është një mjet i cili bën transportin e punonjësve nga qendra ku punohet në banesat e tyre. Distanca më e largët e mundëshme e transportit është rreth 5 km.

- i) Informacioni për lejet, autorizimet dhe liçencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin/ autorizimin/liçencimin e projektit.

Veprimtarija prodhuese që zhvillohet në këtë subjekt është e nevojshme të pajiset me autorizimet dhe liçencat e nevojshme të përcaktuara në legjislacionin e vendit tonë. Kështu mund të citojmë :

- Leje Mjedisi Tipi B.

- Çetifikatë cilësie sipas Standartit ISO 9001-2008.
- Çetifikatë mjedisi sipas Standartit ISO 14001-2004.
- Çetifikatë e sigurisë dhe mbrojtjes në punë sipas Standartit ISO OHSAS 18001-2007.

j) Kopje të lejeve, autorizimeve dhe liçencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacioni në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin/autorizimin/liçencimin e projektit.

Subjekti është i çertifikuar dhe standartizuar me ISO 9001-2008 për prodhimet e konstruksioneve metalike, enëve në presion, etj.